

*Known*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990; *Seb Offensive in Drenica Stes Up, Many Albanians Killed and Slain*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990.

### Hajrush (Qamil) Ahmeti

(9.12.1939, shqiptar nga Lubaveci/Ljubovac, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Hajrushu punonte në fabrikën e tjegullave *Ardhmëria/Budučnost* në Skënderajt/Srbica. Në datën **22.09.1998**, për shkak të sulmit të forcave serbe mbi fshatin, Hajrushu e ka strehuar familjen në shtpatet e *Çiçavicës/Čičavica*, ndërkaq ai me vëllain Jusufin dhe kushërinjtë u tërhoqën më thellë në pyll. I tha familjes së do të kthehej nga mbrëmja. Më vonë, Hajrushu u nda nga Raifi dhe burra të tjerë. Tha se do të shkonte te i biri Fatmiri, i cili ishte pjesëtar i UÇK-së, për t'i çuar pak ushqim [të shikohet regjistrimi më lartë]. Tri ditë nuk kishte kurrfarë njohuri për Hajrushin. Në datën 24.09.1998, trupin e tij e kanë gjetur në pyll përmbi shtëpi [Lubavec/Ljubovac]. E varrosën po atë ditë në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata M.A, FDH-17313; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; *Identity of Five Other Albanians, Killed in Drenica, Made Known*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990.

### Zyhrije (Ajet Ahmeti) Ngucati

(3.05.1958, shqiptare nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, gjashtë fëmijë)

Zyhrija me bashkëshortin Samiun dhe fëmijët jetonin në fshatin Marinë/Marina. Kur filloi ofensiva e forcave serbe në rajonin e *Drenicës/Drenica* më **22.09.1998**, pjesëtarë të këtyre forcave kanë hyrë në Marinë/Marina. Si i dëgjuan të shtënat e para në fshat, Zyhrija me fëmijët e braktisën shtëpinë dhe u nisën në drejtim të fshatit fqinj të Rezallës/Rezala. Lëviznin në formë të kolonës përmes livadheve. Bombardimi dhe krismat nuk pushonin. Kur arritën te pylli [Marinë/Marina], një granatë ka eksploduar jo shumë larg Zyhrijes. Ciflat e saj e kanë qëlluar në shpinë. Ka ndërruar jetë në vend. Komshinjtë e saj i morën fëmijët e

Zyhrijes me vete dhe shkuan drejt Rezallës/Rezala, ndërkaq trupi i saj mbeti në vendin e vrasjes. Një ditë më vonë, Samiu e ka varrosur Zyhrijen në varrezat e Marinës/Marina.

**Burimet:** deklarata M.N, FDH-19876; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

### Halim (Xhemajl) Avdiu

(12.05.1939, shqiptar nga Mikushnica/Mikušnica, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dy fëmijë)

Halimi merrej me punimin e tokës. Me bashkëshorten Zahiden jetonin në bashkësi me djaln Izetin, të rejën Hanen dhe katër djemtë e tyre. Herët në mëngjes, më **22.09.1998**, forcat serbe e bombarduan Mikushnicën/Mikušnica. Halimi e çoi familjen me banorë të tjerë që shkuan në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*, përderisa ai ndenji në shtëpi që të kujdesej për bagëtinë [Mikushnicë/Mikušnica]. Ishte kjo hera e fundit kur familja e shihte atë të gjallë. Izeti u kthye ditën tjetër në fshat për ta vizituar të atin. Lajja e tyre ka qenë e shkruar nga zjarri, ndërkaq Halimi nuk ishte atje. Izeti mësoi se në shtëpinë e Hamdi Bedritut ishin gjetur mbetjet mortore të një burri. Nuk dinte për kë bëhej fjalë, përderisa djali i vëllait të Halimit, Abiti, nuk i njohu opingat që ia kishte dhuruar Halimit vetëm disa ditë më parë. Izeti i mblodhi mbetjet mortore të të atit në një qese najloni dhe i fshehu në bodrum. Tri ditë më vonë, më 26.09.1998, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Halimit në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata Z.A, FDH-16639; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

### Abedin (Avdulla) Vojvoda

(5.02.1952, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Abedini me bashkëshorten Adilen dhe pesë fëmijë jetonin në *Mëhallën Vojvoda* në Llaushë/Lauša. Aderoi në UÇK në muajin qershor të vitit 1998. Kur pjesëtarët e forcave serbe u stacionuan përreth fshatit, Abedini e ka çuar familjen në Qirez/Či-